



Pranuar / Doretuar Prilbena / Prodato Received / Delivery	01 - 11	2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHK	6813	2023	116	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1243/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1243/2023 të datës 03.10.2023 të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë _____

kundër Vendimit numër 02Nr.305 të datës 29.09.2023 të Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë në Komunën e Istogut, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1243/2023 e datës 03.10.2023 të parashtruar nga ankuesi _____
- II. Shfuqizohet Vendimi numër 02Nr.305 i datës 29.09.2023 i Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë në Komunën e Istogut.
- III. Anulohet procedura e ngritjes në detyrë sipas Konkursit me Nr.Referencë: RN00011919 të shpallur më datë 20.06.2023 nga Komuna e Istogut për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Kadastrit dhe çdo veprim tjetër që rrjedh nga kjo procedurë.
- IV. Obligohet Kryetari i Komunës së Istogut, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Komuna e Istogut më datë 20.06.2023 ka publikuar Konkursin me Nr. Reference: RN00011919 për ngritje (avancim) në detyrë për pozitën *Udhëheqës i Sektorit të Kadastrit*, në të cilin konkurs kanë aplikuar tre (3) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesi i cili i është nënshtruar fazave të procedurës (verifikimit paraprak, testit me shkrim, vlerësimit të jetëshkrimit dhe intervistës me gojë).

Pas përfundimit të procedurës, më datë 15.09.2023 është publikuar njoftimi për rezultatin përfundimtar me kandidatin me 84.33 pikë dhe ankuesi me 67.67 pikë. Ankuesi ndaj këtij njoftimi ka parashtruar ankesë tek Komisionit i Vlerësimit për ngritje në detyrë. Komisioni i Vlerësimit për Ngritje në Detyrë i Komunës së Istogut më datë 29.09.2023 ka nxjerr Vendim me numër 02 Nr.305 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi kundër Vendimit numër 02Nr.305 të datës 29.09.2023 të Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë në Komunën e Istogut, më datë 03.10.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 6374/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Istogut. Ndërsa kjo fundit më datë 12.10.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në shqyrtim.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova:Ankesën me numër protokoll 6374/2023 e datës 03.10.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin numër 02Nr.305 të datës 29.09.2023 të Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë në Komunën e Istogut; Njoftimi i datës 28.09.2023 i SIMBNJ për ankuesin; Ankesën e ankuesit e parashtruar në Komisionin e Vlerësimit për Ngritje në Detyrë në Komunën e Istogut; Konkursin me Nr. Reference: RN00011919 për ngritje (avancim) në detyrë për pozitën *Udhëheqës i Sektorit të Kadastrit*; Njoftimin për rezultatet preliminare të verifikimit paraprak e datës 09.08.2023; Njoftimin për rezultatet e vlerësimit i datës 15.09.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 09.10.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 12.10.2023; Listën e aplikantëve të aprovuar; Vendimin Nr. 01-810/023 i datës 31.08.2023 për themelimin të Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë; Njoftimin për test me shkrim; Listën e vlerësimit të jetëshkrimit për ankuesin dhe kandidatin Listën e renditjes përfundimtare të kandidatëve; Diplomën me Nr. 546/0110 për kandidatin Diplomë me Nr. 498/0814 për kandidatin Certifikatën trajnimi maj 2023, Certifikatat e trajnimit 2021, Mirënjohje qershor 2018, 2016, Certifikatën për periudhën 23-24.02.2015, Certifikatën trajnimi 2014, Certifikatën për periudhën 01.06.2010 deri 31.12.2010, Certifikatën e datës 19.11.2015, Akt Emërimit e datës 01.07.2021 e kandidatit Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 01.02.2017 për kandidatin S.M, Certifikatën e datës 30.07.2016, Referencë e datës 04.10.2022, Formularin për vlerësimin e rezultateve enë punë i datës 30.01.2023 dhe 01.02.2022, Dokument identifikimi i kandidatit Certifikatën mbi dënimet penal e datës

04.04.2023; Diplomën me Nr. 1998 e ankuesit, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 26.05.2023, Vërtetimi i datës 26.05.2023, Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 16.12.2022 dhe 28.12.2021, Dokument identifikimi i ankuesit, Akt Emërimit e darës 06.08.2011, Vendimin e datës 05.11.2018, Vendimin e datës 25.06.2018, Akt Emërimit e datës 06.01.2016, Vërtetimi i marrëdhënies së punës i datës 07.07.2015, Certifikatën e datës 30.05.2014, Certifikatën e KJR, Certifikatën mars 2014, Certifikatën prill-qershor 2011, Certifikatën për periudhën 16-17.11.2017, Certifikatën e trajnimit mars 2020, tetor 2019, Certifikatën e datës 16.09.2021, Certifikatën e datës 11.10.2017, Certifikatën mars 2021, Certifikatën nëntor 2022, Certifikatën maj 2023; Diplomën me Nr. 2827 e kandidatit Diplomën me Nr. 1332, Certifikatën e datës 21.05.2007, Marrëveshja për angazhim në masën aktive të tregut të punë e datës 05.03.2019, Certifikatën e datës 15.05.2008, Certifikatën mars 2021, prill 2021, Marrëveshja për angazhim në masën aktive të tregut të punë e datës 18.09.2019, Marrëveshja për angazhim në masën aktive të tregut të punë e datës 01.04.2022, Marrëveshja për angazhim në masën aktive të tregut të punë e datës 04.10.2021, Marrëveshja për angazhim në masën aktive të tregut të punë e datës 01.10.2020, Marrëveshja për angazhim në masën aktive të tregut të punë e datës 31.03.2021, Rekomandimin e datës 11.07.2023, Dokument identifikimi i kandidati Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 31.12.2021 dhe 30.01.2023, Vërtetimin e datës 06.07.2023, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 07.06.2023, Akt Emërimit 02 Nr.65/2022 i datës 26.04.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës të parashtruara nga palët në këtë procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e **bazuar sepse:**

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit numër 02Nr.305 të datës 29.09.2023 të Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë në Komunën e Istogut, pretendon se ky komision nuk ka shqyrtuar fare pretendimet ankimore; Në këtë procedurë ka kandidatë që nuk kanë plotësuar kushtet e konkursit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se sipas Konkursit me Nr. Reference:RN00011919 për ngritje (avancim) në detyrë për pozitën *Udhëheqës i Sektorit të Kadastrit*, si kriteret të përgjithshme formale kanë qenë:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve. Fakulteti Juridik*
- *Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase;*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.*

Në bazë të provave materiale të lëndës, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi ndaj njoftimit të rezultateve të vlerësimit ka parashtruar ankesë tek Komisioni i Vlerësimit për Ngritje në Detyrë në Komunën e Istogut lidhur me pretendimet për mos publikim të listës së verifikimit paraprak brenda afateve ligjore dhe mos plotësim të kriterëve të konkursit nga një kandidat, ndërsa



Komisioni i Vlerësimit për Ngritje në Detyrë i Komunës së Istogut me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 02 Nr.305 të datës 29.09.2023, nuk ka shqyrtuar në tersi pretendimet ankimore të ankuesit, konkretisht ka shqyrtuar pretendimin e ankuesit lidhur me publikimin e njoftimit të verifikimit paraprak mirëpo jo në kuptimin siç është ngritur edhe pretendimi i palës ankuese, po ashtu nuk ka shqyrtuar fare pretendimin tjetër të paraqitur nga ankuesi duke vendosur në mënyrë të përgjithësuar sa i përket kësaj çështje, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, konstaton faktin se Komisioni i Vlerësimit për Ngritje në Detyrë i Komunës së Istogut me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 02 Nr.305 të datës 29.09.2023 ka vepruar në kundërshtim me nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.5 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Ndërlidhur me çështjen sa i përket afatit për publikimin e njoftimit për verifikim paraprak, Kolegji i Këshillit, konstaton se afati i fundit për aplikim për këtë pozitë ka qenë data 12.07.2023 ndërsa njoftimi për rezultatet preliminare të verifikimit paraprak është publikuar më datë 09.08.2023, e që nënkupton se kjo listë është publikuar jashtë afatit të përcaktuar me nenin 45 paragrafi 4 të Rregullores Nr.16/2022 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se: *"...Lista e shkurtër shpallet në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje, jo më vonë se shtatë (7) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të aplikimeve"*, si rrjedhojë pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se ka kandidatë që nuk kanë plotësuar kushtet e konkursit, Kolegji i Këshillit duke marr për bazë provat materiale gjegjësisht listën e aplikantëve me dosjet përkatëse, konstaton faktin se në këtë procedurë kanë aplikuar tre (3) kandidatë e të cilët janë përfshirë në listën e verifikimit paraprak, ndërsa në shqyrtim të aplikacioneve të të gjithë këtyre kandidateve, rezulton fakti se ankuesi dhe kandidati kanë plotësuar kushtet e konkursit, ndërsa lidhur me aplikacionin e kandidatit Kolegji i Këshillit, konstaton se i njëjti posedon Diplomën me Nr. 1332 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës përmes të cilës dëshmohet se më datë 25.06.2011 ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik duke marr titullin Baçelor i Drejtësisë, ndërlidhur me përvojën e punës si prova materiale në aplikacionin e këtij kandidati evidentohet Marrëveshja për angazhim në masën aktive të tregut të punës e datës 05.03.2019 për një periudhë gjashtë muaj, Marrëveshja për angazhim në masën aktive të tregut të punës e datës 18.09.2019 për një periudhë nga data 16.09.2019 deri më datë 15.03.2020 si praktikant, Marrëveshja për angazhim në masën aktive të tregut të punës e datës 01.04.2020 për një periudhë nga data 01.04.2020 deri më datë 30.09.2023, Marrëveshja për angazhim në masën aktive të tregut të punës e datës 01.10.2022 për një përudhe prej datës 01.10.202 deri më datë 30.03.2021 dhe Marrëveshja për angazhim në masën aktive të tregut të punës e datës 04.10.2021 për një periudhë nga data 04.10.2021 deri më datë 02.04.2022 e të gjitha këto marrëveshje janë në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës dhe Komunës së Istogut dhe me qëllim që praktikantet e angazhuar të mos ju ndërprehet angazhimin në organet Komunale. Nëse i referohemi këtyre marrëveshjeve, vijmë në përfundim se këto marrëveshje kanë të bëjë me angazhim si praktikant, ndërsa nëse i referohemi dispozitave të nenit 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, është përcaktuar se: *"4. Puna praktike e praktikantit me përgatitje pasuniversitare, universitare dhe të lartë mund të zgjasë më së shumti një (1) vit, ndërsa puna praktike e praktikantit me shkollim të mesëm mund të zgjasë më së*

shumti gjashtë (6) muaj”, si rrjedhojë praktika e këtyre kandidatëve mund të merret si përvojë punës vetëm ajo praktikë e cila është për një periudhë një (1) vjeçare). Po ashtu duke marr parasysh aplikacionin e këtij kandidati Kolegji i Këshillit, ka gjetur se i njëjti ka themeluar marrëdhënie pune në Komunën e Istogut sipas Akt Emërimit 02.Nr.65/2022 të datës 26.04.2022 në pozitën Zyrtar Ligjor 1.

Kështu që lidhur me procedurën e ngritjes (avancimit) në detyrë, respektivisht kushteve dhe kërkesave për ngritjen në detyrë, Kolegji i Këshillit, ju referuar dispozitave të 53 paragrafi 1, paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Rregullores Nr.16/2022 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se: *“1.Për të aplikuar për ngritjen në detyrë, personi duhet të plotësojë së bashku, kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurohet. 2.Kushtet për ngritjen në detyrë janë: 2.1. nëpunësi të ketë të paktën tre (3) vjet pune në pozitën e një kategorie më të ulët. Në rastin e procedurës për ngritjen në detyrë në një pozitë të kategorisë të ulët drejtuese, periudha e punës provuese llogaritet si kohë e përvojës në punë...”*, rrjedhimisht sipas kësaj norme Kolegji i Këshillit, konstaton se për procedurën e ngritjes në detyrë në një pozitë më të lartë atëherë nëpunësi duhet të jetë i emëruar së paku për tri (3) vite në një pozitë me të ulët, e që në rastin konkret kandidat fitues nuk ka pasur akt emërim të lidhur mes tij dhe Komunës së Istogut apo ndonjë institucionit tjetër në shërbimit civil për këtë periudhë kohore, si rezultat i kësaj, Kolegji i Këshillit, konstaton se ky kandidat nuk ka plotësuar kushtet për ngritje (avancim) në karrierë, ngase nuk janë plotësuar kushtet ligjore për këtë procedurë të avancimit.

Marr parasysh këtë konstatim, Kolegji i Këshillit, thekson faktin se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Istogut me rastin e përfshirjes së këtij kandidati në verifikimin paraprak ka vepruar në kundërshtim me nenin 57 ndërlidhur me nenin 45 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores Nr.16/2022 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që pretendimet e ankuesit janë të bazuara, kështu që Vendimi numër 02Nr.305 i datës 29.09.2023 i Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë në Komunën e Istogut është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Sipas konstatimeve si më sipër, Kolegji i Këshillit, konstaton se për shkak të shkeljeve të cekura si më lartë, atëherë në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi, obligohet Kryetari i Komunës së Istogut që të bëjë zbatimin e këtij vendimi.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1243/2023, datë 01/11/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Istogut
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Istogut dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.